2015

RAPORTI

VJETOR I AKTIVITETIT EITI



EITI
Extractive Industries Transparency Initiative
ALBANIA

Një vlerësim i përgjithshëm i performancës vjetore

Viti 2015 bëhet viti i dytë ku Sekretariati Shqiptar EITI publikon dy raporte, Raportin EITI 2013 dhe Raportin EITI 2014. Përveç taksave dhe pagesave të tjera të kryera ndaj qeverisë nga sektori i naftës, gazit dhe minierave, këto dy raporte përfshijnë për herë të parë edhe deklarimin dhe analizën për transparencën e të dhënave në sektorin e hidroenergjisë. Deloitte Audit Albania, Administratori i Pavaruar, përpiloi dhe koordinoi rakordimin e raporteve EITI për dy vitet fiskale.

Sekretariati Shqiptar EITI nisi hartimin e planit të punës në përputhje me standartin EITI. U bë një riorganizim i aktiviteteve duke përfshirë dhe aktivitetet e parealizuara të planit të punës në vitin 2014. Rol të veçantë përgjatë vitit 2015 luajti dhe përgatitja e disa studimeve si *"Studimi mbi kapacitetet potenciale të të ardhurave nga Industria nxjerrëse"* me synim informimin e publikut dhe rritjen e transaprencës mbi të ardhurat potenciale nga industria nxjerrëse. Risia e përfshirjes së sektorit të hidroenergjisë për herë të parë të burimeve ujore në raportet EITI 2013 dhe EITI 2014, kërkoi të përgatitej dhe paraqitej së pari një *"Studim fizibiliteti mbi burimet hidro"* në Shqipëri. Publikimi i *"Studim fizibiliteti për sistemet e integruara të të dhënave EITI"*, një studim i bazuar mbi sistemet aktuale të të dhënave dhe mundësia e një gjenerimi të një sistemi ku të gjenerohen automatikisht të dhënat për raportin EITI. Gjithashtu, Sekretariati Shqiptar EITI publikoi studimin *"Harta Ushtrimore e Industrisë Nxjerrëse"*, për mbledhjen, përpunimin dhe publikimin e të dhënave EITI në 9 zona të industrisë nxjerrëse.

Për herë të parë nga një konsulent i huaj me eksperiencë ndërkombëtare, Sekretariati Shqiptar EITI organizoi trajnime për grupet e interesit dhe stafin EITI. Përmendim këtu workshop-in tre ditor, zhvilluar në fillim të dhjetorit për shoqërinë civile, parlamentarët, zyrtarët, gazetarët dhe antarët e MSG-së rreth çështjeve kyçe në mirë funskionimin e nismës EITI si Qeverisja e Burimeve Natyrore, Standarti EITI, Aspektet Sociale dhe Mjedisore, Regjimi Fiskal, Legjilacioni dhe Kontratat në industrinë nxjerrëse në Shqipëri.

Strategjia e Komunikimit e dizenjuar të rrisë më tej ndërgjegjësimin e popullatës rreth Nismës EITI dhe menaxhimit të të ardhurave nga industria nxjerrëse dhe arritjen e objektivave bërthamë të Sekretariatit Shqiptar EITI, u implementua me sukses duke transmetuar kështu për herë të parë në televizionet kombëtare dhe lokale, reklamën e re EITI Albania. Drejtuesja e Sekretariatit EITI, Znj. Dorina Çinari ishte pjesë e shumë intervistave televizive dhe medias së shkruar duke ju përgjigjur pyetjeve për objektivat dhe misionin EITI.

Vlerësimi i performancës kundrejt objektivave dhe aktiviteteve të përcaktuara në planin e punës

MSG dhe Sekretariati pas diskutimeve arritën në një konkluzion të përbashkët ku vlerësuan dhe miratuan Planin e Punës EITI 2015. Më poshtë gjenden të listuara objektivat dhe aktivitetet që Sekretariati Shqiptar EITI aplikoi përgjatë vitit 2015.

Objektivi 1 Plani i Punës 2015

U vlerësua që Plani i Punës do të ndjekë praktikat, standartet dhe parimet e dala nga Standarti EITI. Pjesmarrja e grupeve të interesit ishte një komponent integral në planifikimin, mbledhjen e informacionit, vlerësimin e raportit, dhe përhapjes së rezultateve.

Objektivi 2 MSG

Angazhimi i MSG në 2015 ishte shumë aktiv. Përmendim këtu miratimin e termave të referencës dhe nënshkrimin e kontratës me Administratorin e Pavarur për Raportet EITI 2013 dhe EITI 2014. MSG në 2015 zbatoi dhe pasqyroi realisht zgjerimin e pjesëmarrjes së grupeve të interesit dhe shoqërisë civile, ku me kërkesë të kryetarit të MSG z. Ilir Bejtja në mbledhjet e Bordit përveç antarëve të MSG mund të marrin pjesë edhe përfaqësues nga institucione apo organizata të tjera si dhe të ftohen në çdo mbledhje kontribuesit e përhershëm të Nismës EITI. Dy vendet vakante nga shoqëria civile u zëvendësuan në MSG dhe u plotësuan në bazë të propozimit dhe proçedurave të vetë shoqërisë civile me dy antarë të rinj, një përfaqësues nga zona minerare dhe një përfaqësues nga zona naftëmbajtëse.

Objektivi 3 Ndërgjegjësimi i opinionit publik ndaj transparencës

Qëllimi i Strategjisë së Komunikimit EITI është ndërgjegjësimi i opinionit publik ndaj transparencës në industrinë nxjerrëse. Sekretariati Shqiptar koordinoi një fushatë publicitare duke përzgjedhur një kompani publicitare dhe bazuar në strategjinë e komunikimit projektoi mjetet e komunikimit. U realizua dhe u transmetua për herë të parë në mediat lokale dhe kombëtare reklama e re për EITI-in Shqiptar. U përcaktuan dhe u zhvilluan, takime informale me gazetarët, konferenca shtypi për publikimin e Raportit EITI 2013 dhe EITI 2014, intervista në median e shkruar dhe atë televizive, për herë të parë një përmbledhëse me të dhënat kryesore të raporteve EITI 2011 dhe 2012 si dhe realizimi i një fletëpalosjeje dhe *banneri* prezantues me logon dhe emrin e Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse. Vëmëndje të veçantë morri dhe media sociale.

Objektivi 4 Studim mbi kapacitetet potenciale të të ardhurave nga industria nxjerrëse

Sekretariati Shqiptar EITI dhe MSG bazuar në financimin nga Banka Botërore për llogari të Sekretariatit Shqiptar EITI bën kërkesë për shprehje interesi në përzgjedhjen e një firme për të kryer një studim mbi *Potencialin e të ardhurave nga industria nxjerrë në Shqipëri.* Më datë 2 prill 2015, u nëshkrua kontrata me konsulentin fitues Ernst & Young et Associes. Ky studim synonte kontributin e mundshëm të rezervave të industrisë nxjerrëse, hidrokarbure dhe minerare në Shqipëri në funksion të rritjes së të ardhurave në buxhetin e shtetit dhe GDP-së.

Objektivi 5 Studim fizibiliteti mbi burimet hidro

Sektori i hidroenergjisë, edhe pse me kontribut relativisht të ulët në PBB dhe në të ardhurat e Buxhetit të Shtetit, ka peshë të rëndësishme në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të vendit dhe për herë të parë, në raportet EITI 2013 dhe EITI 2014 u publikuan të dhëna nga ky sektor. Përpara marrjes së një vendimi nga ana e MSG-së dhe Sekretariatit për ti përfshirë edhe burimet ujore në raportimet EITI, u pa e nevojshme kryerja e një studimi për vlerësimin e kontributit të sektorit të prodhimit hidroenergjisë në ekonominë shqiptare. Më datë 11 shkurt 2015 u nënshkrua një kontratë me Deloitte Audit Albania shpk dhe më 7 Prill 2015 realizimi i studimit dhe më tej publikimi i tij.

Objektivi 6 Studim fizibiliteti për sistemet e integruara të të dhënave

Financimi nga Grandi i Bankës Botërore mudësoi shërbimin për përzgjedhjen e një firme konsulence për Studimin e *Sistemeve të Integruara të të Dhënave EITI në Shqipëri*. Ky studim synoi prodhimin e një raporti teknik i cili jep informacion mbi statusin aktual të sistemeve të Institucioneve Shtetërore për sa i përket mundësisë së gjenerimit të të dhënave për EITI-in dhe propozimin e një zgjidhje IDMS për prodhimin e integruar të të dhënave EITI. Referuar proçedurave të përzgjedhjes së Bankës Botërore u përzgjodh DM Consulting Services (DMCS) dhe më datë 04 Shkurt 2015 u nënshkrua kontrata. 26 Mars 2015 realizimi i studimit dhe më tej publikimi i tij.

Objektivi 7 Harta ushtrimore për industrinë nxjerrëse

Grupi punës gjithashtu pa të nevojshme hartimin e një studimi pilot, hartë ushtrimore për mbledhjen, përpunimin dhe publikimin e të dhënave EITI. Objektivi kryesor i këtij shërbimi është grumbullimi dhe përpunimi i të dhënave të nevojshme për të ndërtuar dhe funksionuar një linjë informacioni publik online për të njohur, përdorur, analizuar dhe vlerësuar të dhënat e treguesve ekonomiko-sociale dhe ligjore të zonave të industrisë nxjerrëse si dhe objektivat e arritura me qëllim për të iniciuar masa e veprime konkrete në ecurinë e mëtejshme në zonat e industrisë nxjerrëse. Referuar proçedurave të përzgjedhjes së Bankës Botërore u përzgjodh DM Consulting Services (DMCS) dhe më datë 26 Tetor 2015 u nënshkrua kontrata. 24 Dhjetor 2015 realizimi i studimit në bashkëpunim me Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë, Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore, agjencitë e tjera të lidhura ngushtë me Nismën EITI në Shqipëri dhe publikimi i tij.

Objektivi 8 Raportimi i aktiviteteve vjetore 2014

Raporti i aktiviteteve vjetore 2014 referuar objektivave të planit të punës 2014, bëri një vlerësim të performancës dhe ecurisë së Sekretariatit Shqiptar EITI gjatë vitit 2014.

Objektivi 9 Raportet EITI 2013 dhe EITI 2014

Sekretariati Shqiptar EITI publikon raportin e gjashtë EITI. Më 23 dhjetor 2015 u lançua Raporti EITI 2013 dhe 2014. Përveç taksave dhe pagesave të tjera të kryera ndaj qeverisë nga sektori i naftës, gazit dhe minierave, ky raport i rakordimit të të dhënave për vitet fiskale 2013 dhe 2014, përfshin për herë të parë edhe të dhëna nga sektori i hidroenergjisë. Deloitte Audit Albania, Administratori i Pavaruar përpiloi dhe koordinoi rakordimin e raportit EITI për dy vitet fiskale. Më 27 korrik 2015, në ambjentet e Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, Deloitte Audit Albania së bashku me Sekretariatin Shqiptar EITI organizuan një seminar informues dhe koordinues me të gjithë adminitratorët e kompanive minerare, naftës dhe të hidroenergjisë për pjesën e deklarimit dhe raportimit të të dhënave. Të pranishmëve ju vunë në dispozicion të gjitha instruksionet, format dhe dokumentacionet përkatëse për raportimin EITI të viteve 2013 dhe 2014. Ky raport u diskutua dhe u miratua nga MSG në mbledhjen e dhjetorit dhe u publikua në faqen zyrtare EITI Shqiptar. Drejtuesja e Sekretariatit EITI Znj.Dorina Çinari më 8 janar 2016 zhvilloi dhe intervistën e parë televizive për publikimin e Raportit EITI 2013 dhe EITI 2014.

Objektivi 10 Rakordim – Mirëqeverisja e të ardhurave nga industria nxjerrëse në pushtetin vendor

MSG dhe Sekretariati Shqiptar EITI në mbledhjen e datës 23 mars 2015 morrën vendim për ngritjen e një grupi pune me objekt “Rakordimi i të ardhurave të marra nga renta minerare nga Bashkia Patos dhe administrimi i fondeve në dobi të komunitetit për vitin 2012”. Bashkia Patos për vitin 2012 ka përfituar rentën minerare në nivele më të larta se zonat e tjera të industrisë . Ky raport është hartuar nga Sekretariati Shqiptar EITI në bazë të të dhënave të raportuara nga Ministria e Financave, Drejtoria e Buxhetit, vlerësim të punës dhe proçedurave të ndjekura në Bashkinë Patos dhe Komunën Mbrostar. Studimi u publikua më 09 Tetor 2015.

Objektivi 11 Institucionalizimi i EITI Shqiptar

Parlamenti i Shqipërisë më 12 mars 2015 miratoi amendimin e ligjit hidrokarbur nr. 7746, datë 28.07.1993 (kërkim dhe prodhim) në të cilën u parashikua klauzola edhe për Nismën EITI në Shqipëri. Në kuadër të Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse, kontraktorët që kanë lidhur marrëveshje hidrokarbure, organet e administrates tatimore dhe doganore, si dhe organet e qeverisjes qëndrore dhe

vendore kanë detyrimin të raportojnë sipas standartit të caktuar nga kjo nismë, pranë Sekretariatit të Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në aktet nënligjore që hartohen sipas detyrimeve të përcaktuara në Nismën për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse e cila ka të drejtë publikimin e këtyre të dhënave.

Objektivi 12 Raporti i MSI Integrity

Në shkurt 2015 Sekretariati Shqiptar EITI publikoi në faqen zyrtare (www.albeiti.org) në gjuhën shqipe, raportin "Ruatja e themeleve, Vlerësimi i Qeverisjes së Grupeve Ndërinstitucionale të Punës të Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse", nga MSI Integrity. Ky raport ju prezantua anëtarëve të MSG për hapat e mëtejshme dhe u diskutua në mbledhjen e radhës të Bordit ku dhe u vendos ngritja e një grupi pune i përbërë nga tre antarë të MSG, një përfaqësues nga shoqëria civile, një përfaqësues nga kompanitë dhe një përfaqësues nga institucionet shtetërore dhe me mbështetjen e Sekretariatit, nxorri të gjitha gjetjet e raportit për Shqipërinë. Duke u nisur nga Raporti i MSI Integrity grupi punës vendosi të përgatisi termat e reja të referencës për MSG.

Objektivi 13 Pasurimi i Raporteve EITI

Në Raportet EITI 2013 dhe 2014 përfshihet raportimi i veprimtarisë së CSR-ve në kuadër të raporteve EITI.

Objektivi 14 Sondazhe mbi impaktin EITI

Pas publikimit të Raportit EITI 2011 dhe Raportit EITI 2012 dhe transmetimit të reklamës EITI në televizonet lokale dhe kombëtare, më 29 Shtator 2015, Sekretariati Shqiptar EITI startoi një anketim të dytë rreth impaktit EITI në komunitet. Numri i pyetësorëve u rrit nga 500 në 700 pyetësor krahasuar me anketimin e parë që u zhvillua më 23 shtator 2014. Kjo nisëm u zhvillua deri më dhjetor 2015 edhe si një mjet promovimi rreth implementimit EITI në Shqipëri duke bërë të mundur takimet e drejtpërdrejta me banorët në zonat e industrisë nxjerrëse të Bulqizës, Librazhdit, Kukësit,

Patosit, Fierit, Përrenjasit dhe Tiranës. Pyetësori konsistoi në 18 pyetje, për të provuar të dhëna se sa njohuri ka popullata në përgjithësi dhe veçanërisht banorët e këtyre zonave rreth punës, të dhënave dhe rezultateve në industrinë nxjerrëse dhe EITI-in Shqiptar. Si rezultat i anketës vihet re se banorët nuk kanë akoma shumë informacion për zhvillimet në industrinë nxjerrëse dhe pakënaqësia e tyre ndaj investimeve të pakta në komunitet.

Objektivi 15 Strategjia e Komunikimit 2016

Paketa për fushatën e ndërgjegjësimit publik për aktivitetet e parashikuara në Strategjinë e Komunikimit 2015 kaloi në disa amendime dhe si rrjedhojë u aplikua edhe në 6 mujorin e dytë të vitit. Kjo bëri që Strategjia e Komunikimit 2016 të shtyhet për vitin 2017, ku dhe është planifikuar përzgjedhja e një firme kompetente dhe të besueshme konsulence.

Objektivi 16 Zgjerimi i kapaciteteve EITI

Sekretariati Shqiptar EITI ndërmorri programe trajnimi duke e vlerësuar të rëndësishme kooperimin dhe ndërtimin e kapaciteteve për parlamentarët, zyrtarët, antarët e MSG, gazetarët dhe stafin EITI mbi qeverisjen e burimeve në industrisë nxjerrëse, regjimin fiskal, legjislacionin, standartin EITI dhe aspektet sociale dhe mjedisore të shkaktuara nga industria nxjerrëse. Sipas proçedurës së përzgjedhjes së Bankës Botërore, Sekretariati Shqiptar EITI përzgjodhi *Columbia Center on Suistainable Invesment School* për trajnimin tre ditor që u mbajt më datat 2-4 dhjetor 2015. Dita parë e trajnimit mblodhi së bashku grupin parlamentar të komisionit për veprimtaritë prodhuese, në një bashkëbisedim i cili u fokusua mbi sfidat e llogaridhënies dhe sesi EITI mund të jetë një mjet për parlamentarët. Në pjesën e dytë të ditës ishin gazetarët dhe akademikët ata që morrën stafetën përballë prezantimeve nga trajnuesit e *Columbia Center on Suistainable Invesment School* rreth qëndrueshmërisë në industrinë nxjerrëse, hyrje në kornizën ligjore dhe fiskale në industrinë nxjërrëse. Dita e dytë e dhe e tretë e trajnimit mblodhi antarët e MSG dhe përfaqësuesit zyrtar nga institucinet që luajnë rolin më të madh në proçesin EITI, si përfaqësues

nga Doganta, Tatimet, Ministria e Financës, Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, Ministria e Energjisë dhe Industrisë, etj. Si fillim të pranishëve ju bë një hyrje rreth sektorit të naftës dhe atij minerar mbi llogaridhënien dhe transparencën që sjell zbatimi i nismës EITI në Shqipëri. Kornizat rregulluese dhe ligjore Shqiptare përmbyllën dhe ditën e dytë të trajnimit. Dita e fundit u fokusua në kornizat fiskale, menaxhimit të të ardhurave si dhe në aspektet sociale dhe mjedisore që influencojnë lidhjen e industrisë me komunitetin.

Objektivi 17 Përhapja e informacionit

Për herë të parë Sekretariati Shqiptar EITI lançon në televizonet kombëtare dhe lokale reklamën EITI. Reklama synon të tërheq vëmëndjen e publikut duke treguar që Shqipëria ka pasuri natyrore por a dimë ne se çfarë ndodh me këto burime. Më pas tregon që është Nisma EITI që publikon të dhëna mbi industrinë nxjerrëse, të dhëna sesa prodhohet, ku ndodhen rezervat natyrore, sa të punësuar ka në këtë industri, çfarë përfitojmë dhe duke mirë menazhuar të ardhurat nga industria nxjerrëse do kemi të mira publike si më shumë spitale, shkolla, infrastrukturë. U pa e nevojshme prodhimi i fletëpalosjeve të reja dhe një përmbledhje me të dhënat kryesore të raporteve EITI 2011 dhe EITI 2012. Në anketimin e dytë që zhvilloi Sekretariati Shqiptar EITI, në zonat dhe banorët e intervistuar u shpërndanë fletëpalosjet e reja.

Vlerësimi i performancës kundrejt kërkesave EITI

Më 23 dhjetor 2015, MSG dhe Sekretariati Shqiptar EITI publikuan në një raport të përbashkët Raportin EITI për vitet fiskale 2013 dhe 2014. U raportuan pagesat nga të gjitha shoqëritë e liçensuara që vepronin në kërkimin e naftës, gazit, hidroenergjisë dhe mineraleve; të gjitha shoqëritë e liçensuara që vepronin në prodhimin e naftës dhe gazit, hidroenergjisë si dhe prodhuesit më të mëdhenj në sektorin minerar. Janë evidentuar gjithashtu edhe regjistrimi e mënyra e regjistrimit të liçensave të marra nga subjektet në industrinë nxjerrëse, lejet e dhëna së bashku me koordinatat e tyre, përmbledhja e të dhënave në përputhje me modelin e dhënë nga FMN për vlerësim dhe zbatim në vitet pasardhëse,

etj. që më parë nuk kanë qënë pasqyruar në raportet EITI. Gjithashtu institucioneve qeveritare ju kërkua të raportonin të ardhurat që kanë arkëtuar nga këto shoqëri. Bazuar edhe mbi kërkesat e standartit EITI, është përfshirë dhe informacioni kontekstual mbi sektorin e nxjerrës dhe atë të hidroenergjisë.

Vlerësimi i performancës kundrejt kërkesave EITI

Kërkesa	Progresi
1. Kërkesa EITI 3.1 *Hartimi i informacionit kontekstual: MSG duhet të miratojë proçedurat dhe përgjegjësitë për përgatitjen e informacionit kontekstual për Raportin EITI. Burimi i informacioni duhet të jetë i qartë.*	Për hartimin e informacionit kontekstual, MSG dhe EITI Shqiptar i kërkuan industrive rregullatore dhe agjencive të ngarkuara me ligj për mbështetjen dhe raportimin EITI për të dhënat jo vetëm fiskale por edhe të tjera që ti sigurojnë Sekretariatit Shqiptar EITI të dhënat makroekonomike, prodhimin, eksportin dhe të ardhurat e mbledhura nga industria nxjerrëse.
2. Kërkesa EITI 3.2 (A) *Ky informacion duhet të përmbajë një përshkrim përmbledhës të regjimit fiskal, përfshirë nivelin e decentralizimit, një pasqyrë të ligjeve dhe rregulloreve përkatëse, si dhe informacion mbi rolet dhe përgjegjësitë e agjencive qeveritare përkatëse.*	Raporti EITI 2013 dhe EITI 2014 evidenton një përmbledhje të kërkesave kryesore të ligjit, rregullores dhe zbatueshmërisë për regjimin fiskal e aplikueshme për secilin sektor.
3. Kërkesa EITI 3.2 (B) *Në rast se qeveria është duke ndërmarrë reforma, atëherë MSG duhet të garantojë që ato të jenë të dokumentuara në Raport.*	Në raportet paraqitet përshkrimi i ndryshimeve të pritshme në legjislacion dhe regjimin fiscal për sektorin e naftës dhe gazit.

4. Kërkesa EITI 3.3 *Raporti duhet të ofrojë një panoramë të industrisë nxjerrëse, përfshirë çdo aktivitet të rëndësishëm kërkimi.*	Paraqitet një pamje e përgjithshme e sektorit të naftës dhe gazit, sektorit minerar dhe hidro-energjisë në Shqipëri. Gjithashtu një informacion për aktivitete të rëndësishme në kërkim-zbulim paraqitet për sektorin e naftës, gazit dhe sektorin minerar.
5. Kërkesa EITI 3.4 (A) *Madhësinë e industrisë nxjerrëse në terma absolute dhe si përqindje të PBB-së, së bashku me një vlerësim mbi aktivitetin e sektorit informal.*	Në raportet paraqitet informacion për PBB matur sipas çmimeve aktuale dhe pesha relative e industrisë nxjerrëse si dhe sektorit të energjisë elektrike. Theksojmë që Ministria e Financave nuk mund të jepte një vlerësim të ekonomisë informale në Shqipëri dhe në mënyrë të veçantë për sektorët e naftës dhe gazit, sektorin minerar dhe të hidro-energjisë.
6. Kërkesa EITI 3.4 (B) *Të ardhurat totale të qeverisë të gjeneruara nga industritë nxjerrëse (përfshirë taksat, renta, bonuset, tarifat dhe pagesa të tjera) në terma absolute dhe si përqindje të të ardhurave totale të qeverisë.*	Të ardhurat e Qeverisë nga flukset kryesore të pagesave përmblidhet në raporte. Pengesat dhe kufizimet për paraqitjen e totalit të të ardhurave për të gjitha përfitimet shpejgohen në sesione të raportit.
7. Kërkesa EITI 3.4 (C) *Eksportet nga industritë nxjerrëse në terma absolute dhe si përqindje të totalit të eksporteve.*	Informacioni për eksportet nga industria nxjerrëse në terma absolute dhe në përqindje ndaj totalit të eksporteve nënvizohen në raport.
8. Kërkesa EITI 3.4 (D) *Punësimi në industritë nxjerrëse në terma absolute dhe si përqindje e totalit të punësimit.*	Punësimi në sektorin e industrisë nxjerrëse në terma absolute dhe në përqindje ndaj totalit të punësimit paraqitet në raport.

9. Kërkesa EITI 3.4 (E) *Rajonet/zonat kryesore ku është përqëndruar prodhimi.*	Raporti përmban informacion për rajonet kryesore ku përqëndrohet prodhimi përkatësisht për naftën dhe gazin, për sektorin minerar dhe për sektorin e hidro-energjisë.
10. Kërkesa EITI 3.5 (A) *Vëllimin total dhe vlerën e prodhimit sipas produktit, dhe nëse është e mundur, sipas shtetit/rajonit të origjinës.*	Paraqitet informacion për sasitë dhe vlerat e prodhimit sipas mineraleve dhe rajoneve. Të dhënat e paraqitura dhe çmimet e përdorura për vlerësimin janë referuar qartë me burimin.
11. Kërkesa EITI 3.5 (B) *Vëllimin total dhe vlerën e eksporteve sipas produktit, dhe nëse është e mundur, sipas shtetit/rajonit të origjinës.*	Sasitë, vlerat dhe destinacionet e eksportit janë paraqitur në raport për sektorin e naftës dhe gazit; sektorin minerar dhe sektorin e hidro-energjisë.
12. Kërkesa EITI 3.6 (A) *Një shpjegim të rregullave dhe praktikave ekzistuese në lidhje me marrëdhënien financiare midis qeverisë dhe ndërmarrjeve shtetërore (NSH), p.sh. rregullat dhe praktikat që udhëheqin transfertat e fondeve midis NSH-ve dhe shtetit, fitimet e realizuara, ri-investimet dhe financimin nga palë të treta.*	Rregullat dhe praktikat qeverisëse të marrëdhënieve financiare midis Shtetit dhe shoqërive në pronësi të Shtetit në sektorin e naftës dhe gazit dhe hidro-energjisë përshkruhen përkatësisht në raport për marrëdhëniet midis Shtetit dhe Albpetrol dhe për marrëdhëniet midis Shtetit dhe KESH, OST dhe OSSH. Nuk janë identifikuar shoqëri në pronësi të Shtetit në sektorin minerar.
13. Kërkesa EITI 3.6 (B) *Publikimin e informacionit shpjegues të NSH-ve mbi shpenzimet e tyre gati-fiskale (quasifiscal) si pagesat për shërbimet sociale, infrastrukturën publike, subvencionet e karburantit dhe shërbimin e borxhit kombëtar. MSG duhet të zhvillojë një proçes raportimi që synon arritjen e një niveli transparence të krahasueshëm me flukset e të ardhurave dhe pagesat e tjera, si dhe*	Shteti subvencionon sektorin e energjisë elektrike nëpërmjet rregullimit të kostos së energjisë. Gjithashtu, Shteti jep dhe garanton huatë në sektorin e energjisë elektrike. Këto të dhëna janë paraqitur në raport. Nuk ka pagesa të tjera për subvencione dhe shpenzime fiskale të identifikuara në këto sektorë.

përfshirjen e filialeve të NSH-ve dhe sipërmarrjeve të përbashkëta.	
14. Kërkesa EITI 3.6 (C) *Publikimin e informacionit shpjegues nga qeveria dhe NSH-të mbi nivelin e pronësisë së dobishme në kompanitë minerare, të naftës dhe gazit që operojnë në sektorin vendas të minierave, naftës dhe gazit, përfshirë ato në zotërim të degëve të NSH-ve dhe sipërmarrjeve të përbashkëta, si dhe ndryshimet në nivelin e pronësisë gjatë periudhës raportuese. Ky informacion duhet të përmbajë detaje lidhur me termat bashkëngjitur kapitalit aksioner, si dhe shkallën e përgjegjësisë së tyre për mbulimin e shpenzimeve në faza të ndryshme të ciklit të projektit, si për shembull, kapital i paguar plotësisht, kapital i lirë, fitime nga interesat. Në rast ndryshimesh në nivelin e pronësisë të qeverisë dhe NSH-ve gjatë periudhës raportuese, qeveria dhe NSH-të duhet të bëjnë publike kushtet e transaksionit, përfshirë detaje në lidhje me vlerësimin e të ardhurave. Në rast se qeveria dhe NSH-të kanë dhënë kredi apo garanci kredie për kompanitë minerare, të naftës dhe gazit që operojnë në vend, detajet mbi këto transaksione duhet të publikohen në Raportin EITI.*	Paraqitja e përfitimit që Qeveria dhe Albpetrol kanë direkt në projektet e naftës dhe të gazit në Shqipëri paraqitet në raport. Në sektorin e hidro-energjisë Qeveria ka dhënë kocensione BOT për ndërtimin e HEC-eve të vogla dhe të mesme të cilat do t'i kthehen qeverisë në fund të konçesionit. Gjithashtu të ardhurat nga privatizimi i HEC-ve në vitin 2013 janë paraqitur.
15. Kërkesa EITI 3.7 (A) *Raporti duhet të tregojë se të ardhurat e cilës industri, qoftë cash apo me natyrë të ngjashme, regjistrohen në buxhetin e shtetit. Duhet të ofrohet një shpjegim për shpërndarjen e të ardhurave që nuk janë regjistruar në buxhetin e shtetit, i shoqëruar sipas rastit me linqet e raporteve financiare përkatëse, p.sh. për pasurinë sovrane dhe*	Raporti jep një përmbledhje të shpërndarjes së të ardhurave direkte nga sektori i naftës dhe gazit, sektori minerar dhe ai i hidro-energjisë midis Buxhetit të Shtetit, institucioneve të tjera publike dhe shoqërive shtetërore duke treguar nëse pagesat janë bërë në para apo në natyrë. Pagesat në natyrë janë shënuar dhe identifikuar më vete.

fondet e zhvillimit, qeveritë lokale, ndërmarrjet shtetërore, dhe subjekte të tjera jo-buxhetore.	
16. Kërkesa EITI 3.8 (A) *Një përshkrim të të ardhurave nga industria nxjerrëse të dedikuara për rajone specifike gjeografike. Ai duhet të përshkruajë metodat që garantojnë përgjegjshmëri dhe efikasitet në përdorimin e tyre.*	Buxheti dhe shpenzimet e Qeverisë nuk ofrojnë detaje për mënyrën e alokimit të fondeve sipas programeve specifike në sektorin e naftës dhe gazit, minerar dhe hidro-energjisë. Fondet e planifikuara për tu investuar në sektorin e hidro-energjisë janë të paraqitura.
17. Kërkesa EITI 3.9 (A), (B), (C) *Termi "licensë" në këtë kontekst i referohet çdo liçense, kontrate qiraje, titulli, leje apo koncesioni përmes së cilës qeveria i jep të drejta kompanive apo individëve për kërkim apo shfrytëzim të naftës, gazit dhe/ose burimeve minerare. b) Vendet zbatuese duhet të mbajnë një regjistër publik ose sistem(e) kadastral të pajisur me informacion të duhur dhe të plotë në lidhje me secilën nga licensat në zotërim nga kompanitë e përfshira në Raportin EITI: i. Zotëruesi i liçensës (s). ii. Koordinatat e zonës së liçensës. iii. Data e aplikimit, datën e dhënies dhe kohëzgjatja (vlefshmëria) e liçensës. iv. Në rastin e liçensave të prodhimit, artikullin e prodhuar. Duhet që regjistri i liçensave ose kadastra të përfshijnë informacion që ka të bëjë me liçensat që zotërojnë të gjitha subjektet, përfshirë kompanitë dhe individët ose grupet që nuk janë objekt i Raportit EITI, pasi pagesat e tyre janë nën pragun e miratuar të materialitetit. Barrierat e rëndësishme ligjore ose praktike që pengojnë këtë publikim gjithëpërfshirës duhet të dokumentohen dhe shpjegohen në Raport, së bashku me një përshkrim të planeve të qeverisë lidhur me*	Kushtet kryesore të liçensave dhe të regjistrit të tyre publik jepen për çdo sektor.

përpjekjet për të kapërcyer këto barriera dhe afatet e parashikuara për arritjen e tyre. 24 c) Në rast se informacioni i paraqitur në 3.9 (b) është aktualisht në dispozicion të publikut, atëherë ai duhet të përfshihet si referencë apo link në Raportin EITI. Në rast se regjistri apo kadastra nuk ekziston apo ka mangësi, Raportin duhet të bëjë të njohura të gjitha boshllëqet e krijuara në informacionin publik dhe duhet të dokumentojë përpjekjet e mundshme për forcimin e këtyre sistemeve. Ndërkohë që vetë Raporti duhet të përfshijë informacionin e përcaktuar më sipër në 3.9 (b).	
18. Kërkesa EITI 3.10 (A) dhe (B) *Vendet zbatuese duhet të bëjnë të njohur informacionin lidhur me akordimin apo transferimin e liçensave që zotërohen nga kompanitë e përfshira në Raport, së bashku me: një përshkrim të proçesit për transferimin ose akordimin e liçencës; kriteret teknike dhe financiare të përdorura; informacion lidhur me marrësin(t) e liçensës që është transferuar apo akorduar dhe, sipas rastit, anëtarët e konsorciumit; dhe të gjitha devijimet e rëndësishme nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi që udhëheq transferimin dhe akordimin e liçensave.* *Qeveria duhet të publikojë listën e aplikantëve dhe kriteret për tenderim në rast se liçensat janë akorduar përmes proçesit të tenderimit gjatë periudhës kontabël të përfshirë në raport.*	Informacioni për aktet ligjore dhe njoftimeve përkatëse të alokimit të liçensave dhe komentet për nivelin e transparences paraqiten në raport.

19. Kërkesa EITI 3.11 *Pronësia e dobishme*	MEI njoftoi se aktualisht nuk ka një iniciativë të organizuar për ndërtimin e një regjistri ku do të përfshihen përfituesit direkt dhe jodirekt nga koçensionet e dhëna në sektorët.
20. Kërkesa EITI 3.12 *Kontratat*	Politika e Qeverisë për publikimin e kontratave paraqitet në raport. Kontratat e industrisë minerare janë të evidentuara publikisht në Qëndrën Kombëtare të Liçensimit (QKL). Kontratat e industrisë se naftës mbeten ende te papublikuara.
21. Kërkesa EITI 4.1 (A) dhe (B) *MSG bie dakord, përpara proçesit të raportimit, se cilat pagesa dhe të ardhura kanë rëndësi materiale dhe për këtë arsye duhet të bëhen publike, duke përfshirë përcaktimin e duhur dhe pragun e materialitetit. Pagesat dhe të ardhurat konsiderohen me rëndësi materiale nëse mospërfshirja apo keq-deklarimi i tyre mund të ndikojë dukshëm në tërësinë e Raportit EITI. Raporti duhet të përmbajë një përshkrim të flukseve të të ardhurave, përcaktimin dhe pragun e materialitetit. Gjatë përcaktimit të materialitetit, grupi i punës duhet të marrë në konsideratë madhësinë e fluksit të të ardhurave në raport me të ardhurat totale. Grupi i punës duhet të dokumentojnë opsionet e marra në shqyrtim si dhe arsyetimin llogjik për përcaktimin e bërë. b) Duhet të përfshihen zërat e mëposhtëm të të ardhurave: i. E drejta e qeverisë pritëse mbi prodhimin (si fitimi i naftës). ii. E drejta e ndërmarrjeve shtetërore mbi prodhimin kombëtar. iii. Fitimet nga taksat. iv. Rentat minerare. v. Dividentët. vi. Bonuset, përfshirë bonuset e nënshkrimit, zbulimit dhe prodhimit. vii. Tarifat e liçensave, qirasë,*	Raporti jep informacion për materialitetin dhe pagesat e përzgjedhura, shoqëritë raportuese dhe pagesat e përzgjedhura nga MSG, duke përfshirë komentet për saktësinë dhe kufizimet e informacionit përdorur për të përcaktuar nivelin e materialitetit në përzgjedhjen e shoqërive e subjekteve dhe treguesve e pagesave për raportim.

hyrjes dhe pagesa të tjera për liçensa dhe/ose koncesione. viii. Pagesa të tjera të rëndësishme dhe përfitime materiale bërë tek shteti. Zërat e të ardhurave ose përfitimet duhet të përjashtohen vetëm në raste kur ato nuk janë të zbatueshme, ose kur grupi i punës bie dakord se mos-përfshrija e tyre nuk ndikon në mënyrë thelbësore në tërësinë e Raportit EITI.	
22. Kërkesa EITI 4.1 (C) *Të ardhurat nga shitja e prodhimit shtetëror ose të ardhura me natyrë të ngjashme: Në rastet kur të ardhurat nga shitja e pjesës shtetërore të prodhimit apo të ardhurat e tjera me natyrë të ngjashme janë të rëndësishme, qeveria, përfshirë ndërmarrjet shtetërore, duhet të bëjnë publike vëllimet e shitura dhe të ardhurat e siguruara. Të dhënat e publikuara duhet të ndahen në nivele të krahasueshme me pagesa dhe të ardhura të tjera të raportuara (Kërkesa 5.2.e). Pagesat e publikuara mund të ndahen sipas llojit të produktit, çmimit, tregut dhe vëllimit të shitjes. Në rastet kur është konkretisht e mundur, grupi i punës ngarkon Administratorin e Pavarur për kuadrimin e vëllimeve të shitura dhe të ardhurave të marra duke përfshirë në proçesin e raportimit edhe kompanitë blerëse.*	Pagesat në naftë për ndarjen e prodhimit të naftës kryer ndaj Albpetrol dhe procesi i zbatuar për shitjen e naftës përshkruhen në raport. Detajet e volumeve, vlerave dhe shoqëritë blerëse për vitin 2013 dhe 2014 gjithashtu paraqiten.
23. Kërkesa EITI 4.1 (D) dhe (E) *Sigurimi i infrastrukturës dhe marrëveshjet barter: Grupi i punës dhe Administratori i Pavarur duhet të marrin në konsideratë faktin nëse ka apo jo marrëveshje, apo grupe marrëveshjesh që përfshijnë ofrimin e mallrave dhe shërbimeve (kredi, grante dhe punime në infrastrukturë), në këmbim të plotë*	Evidentohen në raport problemet e marrëveshjes për projektin e gazsjellësit TAP, që lidhet dhe përfshin investime për përmirësime në infrastrukturë në vitet pasardhëse ashtu si dhe vlera e përfitimeve që do të ketë ekonomia Shqiptare. Ndërkohë që nuk ka raportim për marrëveshje për një gjë të tillë në sektorin e naftës, minerar apo hidroenergjisë.

ose të pjesshëm të aktivitetit për kërkim nafte, gazi apo mineralesh, koncesioneve të prodhimit ose transportit fizik të këtyre produkteve. Për ta bërë këtë, grupi ndër-institucional i punës dhe Administratori i Pavarur duhet të kuptojnë plotësisht: kushtet e marrëveshjes dhe kontratat përkatëse, palët e përfshira, burimet e ofruara nga shteti, vlera e zërit balancues (p.sh. punime infrastrukturore), dhe rëndësia e këtyre marrëveshjeve në raport me kontratat e zakonshme. Në rastin kur grupi i punës arrin në përfundimin se këto marrëveshje janë materiale, atëherë nevojitet që grupi i punës dhe Administratori i Pavarur të sigurojnë trajtimin e këtyre marrëveshjeve në Raportin EITI, duke ofruar një nivel detajimi dhe transparence të barabartë me publikimin dhe rakordimin e pagesave dhe zërave të tjerë të të ardhurave. Në rast se rakordimi i transaksioneve kryesore nuk është i mundur, grupi i punës duhet të bjerë dakord për adoptimin e një qasje të re që përfshin deklarimin e njëanshëm të palëve në marrëveshjet që janë pjesë e Raportit EITI. e) Shpenzimet sociale: Nëse shpenzimet sociale materiale të kompanive janë të sanksionuara me ligj apo nga kontrata me qeverinë e cila rregullon investimin përkatës nxjerres, atëherë këto sanksione dhe rakordimi i tyre, në rast se është i mundur, duhet të publikohen në Raportin EITI. i. Është e nevojshme që Raporti të deklarojë natyrën dhe vlerën e llogaritur të të ardhurave nga transaksione me natyre të ngjashme. Kur përfituesi i shpenzimeve sociale të detyrueshme është një palë e tretë, pra jo një agjenci qeveritare, kërkohet të bëhet i ditur emri dhe funksioni i përfituesit. ii. Në rast se rakordimi është i parealizueshëm, Raporti duhet të përfshijë deklaratat e njëanshme të kompanive apo	Provizionet e materialeve të raportuar nga kompanitë që operojnë në ndërtimin e infrastrukturës, shpenzimeve sociale dhe dëmshpërblimeve përfshihen në marrëveshjen e vendeve pritëse të TAP, të cilat cilësohen në raport. Njësitë e qeverisjes vendore janë ftuar dhe kanë raportuar për pagesat mbi 5 000 $ të përfituara nga subjektet e industrisë nxjerrëse dhe qeverisja qëndrore për pagesat mbi 50 000 $ të përfituara si më sipër.

qeverisë lidhur me transaksione të tilla. iii. Nëse grupi i punës vlerëson se shpenzimet sociale diskrecionale dhe transfertat kanë rëndësi materiale, ai duhet të inkurajohet të zhvillojë një proçes raportimi që synon arritjen e një niveli të barabartë transparence me deklarimin e pagesave dhe të ardhurave të tjera të entiteteve qeveritare. Në rastin kur rakordimi i transaksioneve kryesore është i pamundur, për shkak se pagesat e kompanive mund të jenë të një natyre të ngjashme apo të kryera ndaj një pale të tretë jo-qeveritare, grupi i punës mund të pranojë përfshirjen në Raport të deklaratave të njëanshme vullnetare të kompanive dhe/ose qeverisë.	
24. Kërkesa EITI 4.1 (F) *Transporti: Qeveria dhe ndërmarrjet shtetërore duhet të deklarojnë të ardhurat e marra nga transporti i naftës, gazit dhe mineraleve kur këto përbëjnë zërat më të mëdha të të ardhurave në sektorin nxjerrës. Të dhënat e publikuara duhet të ndahen në nivel të barabartë me e zërat e të ardhurave dhe pagesave të tjera të raportuara (Kërkesa 5.2.e). Raporti EITI mund të përmbajë: i. Një përshkrim të marrëveshjeve të transportit, përfshirë: produktin, itinerarin e transportit; kompanitë përkatëse dhe subjektet qeveritare, së bashku me NSH-të e përfshira në transport. ii. Përcaktimet e taksave, tarifave ose pagesave të tjera të rëndësishme të transportit, si dhe metodologjitë e përdorura për llogaritjen e tyre. iii. Publikimin e tarifave dhe vëllimit të mallrave të transportuar. iv. Deklarimin e të ardhurave të marra nga subjektet qeveritare, NSH-të, lidhur me transportin e naftës, gazit dhe mineraleve. 29 v. Grupi i punës inkurajohet, kur kjo gjë është e mundur, të ngarkojë Administratorin e*	Janë pasqyruar në raport kërkesat për pagesat për transportin. Veçanërisht për transportin përmes porteve detare si në Porto Romano, Durrës dhe Petrolifera, Vlorë. Shteti nuk ka asnjë të ardhur e cila përfitohet nga kompanitë menaxhuese që e kanë marrë këtë të drejtë me ligj. Nafta, gazi natyror dhe produktet minerare transportohen nëpërmjet kamionëve për në pikat e shpërndarjes. Nuk ka tubacione funksionale në sektorin e transportit të naftës, gazit natyror dhe produkteve minerare. Informacioni për naftën dhe gazin natyror pasqyrohet në raport

Pavarur me detyrën e rakordimit të pagesave dhe të të ardhurave materiale që lidhen me transportin e naftës, gazit dhe mineraleve.	
25. Kërkesa EITI 4.2 (A) dhe (B) *Raporti EITI duhet të sigurojë përputhshmëri të plotë midis të ardhurave të qeverisë dhe pagesave të kompanive, duke përfshirë pagesat ndaj dhe nga ndërmarrjet shtetërore, në përputhje me qëllimin e rënë dakord (Kërkesa 4.1). Të gjitha kompanitë që kryejnë pagesa materiale për qeverinë duhet t'i deklarojnë ato plotësisht në pajtim me objektin e raportimit. Një subjekt ekonomik mund të përjashtohet nga raportimi vetëm në rast se vërtetohet që pagesat dhe të ardhurat e tij nuk kanë rëndësi materiale. Të gjitha subjektet qeveritare që marrin të ardhura materiale duhet t'i deklarojnë ato plotësisht në përputhje me objektin e raportimit. b) Gjithashtu, në rastet kur ekzistojnë pengesa të rëndësishme praktike, qeveria duhet të japë, në tërësi, informacion mbi sasinë e të ardhurave totale të marra nga secili prej zërave të pranuar në objektin e Raportit EITI, përfshirë të ardhurat që ndodhen nën pragun e përcaktuar të materialitetit. Në rast se këto të dhëna nuk janë të disponueshme, Administratori i Pavarur mbledh të gjitha të dhënat dhe vlerësimet përkatëse nga burime të tjera në mënyrë që të sigurojë një vlerësim gjithëpërfshirës të të ardhurave totale të qeverisë.*	Raporti ofron informacion mbi kufijtë e përcaktuar të materialitetit, raportimin e subjekteve dhe pagesat e përzgjedhura për rakordimin nga MSG, duke pëfshirë komentet mbi saktësinë dhe limitimin e informacionit të përdorur për krijimin e materialitetit, raportimin e subjekteve dhe pagesave te raportuara. Barrierat për deklarimin e plotë të të ardhurave nga sektorët në kuadër të raportimit gjithashtu janë përshkruar.
26. Kërkesa EITI 4.2 (D) *Pagesat lokale: Është e nevojshme që grupi i punës të përcaktojë nëse pagesat direkte që kompanitë u kanë bërë njësive të qeverisjes lokale, të cilat janë brenda objektit të raportimit, kanë rëndësi materiale. Në rast se*	Mbledhja e pagesave të materialeve për shoqëritë shtetërore (Albpetrol dhe KESH) dhe AKBN analizohen në në raport. Të ardhurat e përfituara nga këto burime pagesash rakordohen me subjektet e licensuar që raportojnë për vitet 2013 dhe 2014.

po, grupi i punës duhet të sigurojë që deklaratat dhe rakordimi i pagesave dhe faturave përkatëse të përfshihet në Raportin EITI.	
27. Kërkesa EITI 4.2 (E) *Transfertat lokake: Grupi i punës duhet të garantojë përfshirjen në Raportin EITI të deklaratave të transfertave materiale ndërmjet njësive të qeverisjes qendrore dhe asaj vendore që lidhen me të ardhurat e gjeneruara nga industritë nxjerrëse dhe që janë të sanksionuara nga kushtetuta, statuti apo mekanizma të tjerë për ndarjen e të ardhurave. Raporti EITI duhet të përfshijë formulën e përdorur, nëse ka, për ndarjen e të ardhurave si dhe çdo mospërputhje ndërmjet shumës së transfertës të llogaritur në përputhje me formulën përkatëse për ndarjen e të ardhurave dhe shumës aktuale të transferuar midis njësive të qeverisjes qendrore dhe asaj vendore. Grupi ndër-institucional i punës duhet të kryejë kuadrimin e këtyre transfertave. Grupi 30 inkurajohet të përfshijë në Raportin EITI deklaratat, dhe nëse është e mundur të bëjë kuadrimin, e transfertave diskrecionale apo 'ad-hoc' me rëndësi materiale. Në rast se ka pengesa kushtetuese reale apo domethënëse përsa i përket pjesëmarrjes së njësive vendore, grupi i punës mund të kërkojë zbatim të përshtatur sipas Kërkesës 1.5.*	Tranferimi i rentës minerare drejt NJQV-ve dhe formula e ndarjes së të ardhurave përshkruhet në raport. Asnjë transfertë e rentës minerare nuk është raportuar për zonat e industrisë nxjerrëse minerare nga Ministria e Financave. Vetëm zonat e industrisë nxjerrëse hidrokarbure kanë përfituar në vitet e raportimit 2013 dhe 2014.

Përmbledhje e përgjigjeve të MSG për rekomandimet nga rakordimi dhe validimi, nëse është e aplikueshme

Rekomandimet e Raportit EITI 2013 dhe EITI 2014 janë diskutuar në MSG si më poshtë:

Rekomandimi 1 **Vonesa dhe mospërputhjet**

Në mënyrë që të lehtësohet proçesi i rakordimit dhe përpilimi i raportit, Deloitte Audit Albania sugjeron që të përcaktohet një kalendar vjetor për kryerjen e proçesit të raportimit dhe rakordimit. Afati vjetor për raportim duhet të planifikohet në kohë dhe të përfshihet në kalendarin vjetor të raportimit të shoqërive. Për këtë arsye, përzgjedhja e shoqërive raportuese dhe kërkesave për raportim duhet të planifikohet dhe të komunikohet disa muaj përpara afatit për dorëzimin e raportimit. Gjithashtu, me qëllim që të zvogëlohet numri i mospërputhjeve me pagesat e raportuara nga autoritetet tatimeve, MSG mund t'i kërkojë shoqërive raportuese që të krahasojnë shumën e pagesave të kryera ndaj tatimeve gjatë vitit në raportim me degët rajonale të tatimeve përpara se t'i raportojnë këto pagesave për rakordimin EITI. Ministria duhet të ndjekë zbatimin rigoroz të legjislacionit shqiptar në fuqi lidhur me raportimin financiar dhe auditimin e pasqyrave financiare të shoqërive në sektorin nxjerrës dhe atë të hidroenergjisë. Kjo do të sjellë përmirësim të cilësisë dhe sasisë së informacionit financiar prodhuar për aktivitetet nxjerrëse në Shqipëri.

Rekomandimi 2 **Proçedurat verifikuese**

Në kontekstin e përmirësimit të cilësisë të raportimit të Shoqërive dhe njëkohësisht për të marrë siguri mbi informacionin e raportuar, Deloitte Audit Albania rekomandon që Ministria t'ju kërkojë shoqërive të licensuara të paraqesin pagesat dhe informacione shtese sipas standardit EITI në një raport të veçantë ose në një aneks të pasqyrave financiare vjetore. Në të dy rastet ky informacion duhet të jetë subjekt i auditimit të pavaruar vjetor.

Rekomandimi 3 **Aspekte të tjera cilësore të analizës së pagesave**

Deloitte Audit Albania rekomandon që MEI të rrisë kërkesat rregullatore për të siguruar raportimin e pagesave dhe taksave për secilën licensë më vete. Nëpërmjet krahasimit të pagesave për çdo licensë me nivelin e prodhimit dhe tatimit, MEI mund të përftojë një bazë të mjaftueshme të dhënash për buxhetimin e të ardhurave dhe analizën e efektivitetit të politikave fiskale në periudhë afatmesme dhe afatgjatë.

Rekomandimi 4 **Mangësitë e raportimit të konsoliduar në qeverisjen qëndrore dhe vendore**

Për të përmirësuar kohën, kostot dhe cilësinë e raportimit nga Qeveria, Deloitte Audit Albania rekomandon:

_ Bashkëpunimin me ekipin e raportimit të Qeverisë për të krijuar raporte që mund të prodhohen nga sistemi i Thesarit me informacion për pagesat e mbledhura për çdo taksapagues sipas llojit të taksave. Për disa arsye shpjeguar më poshtë, se qasja në raportet e prodhuar nga sistemet e informacionit të Qeverisjes Qëndrore do të ishte zgjidhja më e mirë.

_ Megjithatë, nëse kjo nuk mund të realizohet në një periudhë afatshkurtër apo afatmesme, Deloitte Audit Albania rekomandon vlerësimin e mundësisë për të marrë këtë informacion nga sistemet e informacionit të agjencive qeveritare që arkëtojnë të ardhura në sektor.

Rekomandimi 5 **Raportimi i Njësive të Qeverisjes Vendore**

NJQV-të kanë autonomi të caktuar në bashkëpunimin me biznesin dhe tatimin e aktivitetit në zonat nën administrim. Për të përmirësuar transparencën e këtij bashkëpunimi në aspektin e pagesave të tatimeve dhe taksave lokale, tarifave për shërbimet, kontributet dhe aktivitetet në dobi të komunitetit lokal, etj. Deloitte Audit Albania rekomandonë zgjedhjen e NJQV-ve për raportim bazuar në nivelin e aktivitetit prodhues raportuar nga AKBN. Përzgjedhja e NJQV-ve për raportim dhe e kërkesave

për raportim duhet të planifikohet dhe të komunikohet disa muaj përpara afatit për dorëzimin e raportimit në mënyrë që të integrohet në kalendarin e raportimeve vjetore të NJQVve.

Rekomandimi 6 **Kufizimet në raportet e prodhuara nga Sistemi i Tatimeve**

Siç rekomandohet edhe më sipër në pikën 7.2.1 për të përmirësuar kohën, kostot dhe cilësinë e raportimit nga Qeveria, MSG dhe EITI Shqipëri duhet të bashkëpunojë me ekipin e raportimit të Qeverisë për të hartuar raporte që mund të prodhohen nga sistemi i Thesarit. Megjithatë, nëse kjo nuk mund të realizohet në një periudhë afatshkurtër apo afatmesme, dhe duke konsideruar madhësinë e të ardhurave që mbledh DPT në sektor Deloitte Audit Albania rekomandon vlerësimin e mundësisë për të prodhuar raporte dhe informacion nga sistemi i tatimeve.

Rekomandimi 7 **Publikimi i statistikave dhe fakteve mbi industrinë nxjerrëse**

Për të përmirësuar plotësinë dhe saktësinë, besueshmërinë dhe aksesin në informacionin kontekstual, Deloitte Audit Albania rekomandonë që Ministria e Energjisë dhe Industrisë të publikojë në mënyrë periodike (të paktën çdo vit) fakte mbi industrinë duke përfshirë: potencialin e industrisë dhe prodhimin aktual, kontributin në ekonomi, strategjinë e sektorit, ngjarje dhe fakte, rregullimin aktual dhe ndryshimet e ardhshme etj. Informacion kontekstual mund të përfshijë informacione të tjera të dobishme për statistikat e sektorit të tilla si:

_ Madhësia e prodhimit dhe detaje të cilësisë (graviteti i naftës, përqendrimi i mineraleve, etj),

_ Investimet (numri i puseve dhe galerive të minierave nën administrim / zhvillim),

_ Projektet për rehabilitimin mjedisor dhe kostot përkatëse,

_ Fuqia punëtore e punësuar, paga mesatare dhe nënkontraktimi, shpenzimet sociale, etj.

Këto informacione mund të mblidhen e të përpunohen çdo vit dhe të shërbejnë si bazë për raportimin e statistikave dhe fakteve për industrinë. AKBN, si institucion i angazhuar gjerësisht në monitorimin e sektorit mund të kontribuojë në përpilimin e informacionit kontekstual nëpërmjet grumbullimit të informacionit nga raportimet vjetore të shoqërive për çdo licensë në AKBN bazuar në treguesit e përcaktuar nga MSG për prodhimin, rezervat, shitjen, numrin e punonjësve, investimet në mjedis,

pagesat sociale etj. Ndër të tjera, përmes përdorimit të treguesve, AKBN mund të përmbledh fakte të bazuara në studimet vjetore të mjedisit duke theksuar rreziqet dhe trendet në nivel vendi, si dhe zona të veçanta ku përqendrohet veprimtaria e operatorëve në sektorin e nxjerrjes dhe të energjisë. Në kuadër të përmirësimit të raportimit dhe statistikave në industrinë nxjerrëse, Deloitte Audit Albania rekomandonë Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë të shqyrtojë nëse do të zbatojë kërkesat e raportimit të ngjashme si në Direktivat e BE-së për Kontabilitetin dhe Transparencën.

Rekomandimi 8 Të dhënat për sasinë dhe vlerësimin e prodhimit

Deloitte Audit Albania rekomandon që AKBN të kryej matje të prodhimit minerar të nxjerrë dhe ta krahasojë atë me vetëdeklarimet e shoqërive. Gjithashtu, vetëdeklarimet dhe krahasimet të përfshijnë të dhëna për cilësinë e mineraleve (nivelin e përqëndrimit) dhe vlerat e transaksioneve në tregun vendas dhe tregjet e eksportit. Çmimet e transaksioneve në vend mund të krahasohen me çmimet në tregjet ndërkombëtare të mineraleve.

Rekomandimi 9 Publikimi i të ardhurave totale që merr Shteti nga industria nxjerrëse

Sistemi qëndror i Thesarit mbledh informacion për çdo pagesë kryer nga taksapaguesit individual, pavarësisht institucioneve që mbledhin këto të taksa ose sektorit ekonomik ku vepron taksapaguesi. Siç është rekomanduar në 7.2.1, nëpërmjet bashkëpunimit me ekipin e raportimit të Qeverisë, MSG mund të marrë të dhëna të plota për të ardhurat gjeneruar nga sektori nxjerrës dhe i hidro-energjisë. Kjo mund të arrihet duke mbajtur një regjistër të përditësuar të licensave në sektor me të dhëna të sakta për numrin e licensës dhe numrin e identifikimit tatimor. Sistemi i informacionit të Qeverisë mund të përdorë të dhënat nga ky regjistër për të prodhuar raportet. Nëse kjo nuk mund të realizohet në një periudhë afatshkurtër apo afatmesme, Deloitte Audit Albania rekomandon vlerësimin e mundësisë për të marrë këtë informacion nga sistemet e informacionit të agjencive qeveritare që arkëtojnë taksa në sektor si tatimet, doganat, dhe NJQV-të, të cilat përfaqësojnë njëkohësisht agjentë të rëndësishëm tatimorë. Përveç përmbushjes së kerkesave të standardit EITI, informacioni i përditësuar nga sistemi i raportimit të Qeverisë do të përmirësojë analizat statistikore në sektor dhe

do të mund të krahasohet me informacione të tjera si niveli i prodhimit, struktura e industrisë, numri i licensave, etj.

Rekomandimi 10 Rezervat

Ne e kuptojmë se vlerësimi i rezervave kombëtare mund të kërkojë shumë vite dhe përbën një kosto të rëndë në Buxhetin e Shtetit. Megjithatë, rezervat janë të rëndësishme për të siguruar informacion kontekstual për vlerën e përgjithshme të pasurisë kombëtare në përputhje me kërkesat e kapitullit 3 të standardit EITI. Deloitte Audit Albania rekomandonë që MEI të vlerësojë përfitimet përkundrejt kostove për vlerësimin e rezervave në të gjithë vendin dhe të caktojë prioritetet për zonat me interes të lartë. Gjithashtu, informacioni koherent për rezervat e provuara dhe të mundshme kombinuar me kontroll efektiv të aktiviteteve të kërkimit dhe nxjerrjes së naftës dhe mineraleve në vend, mund të ndihmojë në planifikimin efektiv të prodhimit dhe atë fiskal si dhe parandalimin e abuzimeve me burimet kombëtare.

Rekomandimi 11 Mbajtja e një regjistri të përditësuar publik të licensave dhe koncesioneve

Vendet anëtare të EITI-t duhet të mbajnë një regjistër publik ose sistem kadastër me informacioin koherent dhe të plotë për çdo licensë dhënë shoqërive përfshirë:

_ Mbajtësin e licensës;

_ Koordinatat e zonës së licensës;

_ Datën e aplikimit, datën e dhënies dhe kohëzgjatjen e licensës; dhe

_ Në rastin e liçensave të prodhimit, mineralin e prodhuar.

Regjistri i licensave apo kadastra do të përfshijë informacion për të gjitha licensat e mbajtura nga të gjitha subjektet, përfshirë edhe shoqëritë, individët apo grupet që nuk janë përzgjedhur për rakordim sipas standardit EITI, sepse pagesat tyre paraqiten nën pragun e materialitetit të përcaktuar. Siç është shpjeguar edhe më herët në këtë kapitull, mbajtja e një regjistri të përditësuar publik do të kontribuojë në përmirësimin e raportimit të të ardhurave të qeverisë nga këto sektorë. Për më tepër,

të dhëna të sakta mbi të licensuarit, numrat e identifikimit tatimor (NUIS), si dhe detajet e kontaktit, adresa, etj. do të lehtësojnë komunikimin me subjektet e përzgjedhura për të raportuar sipas EITI.

Rekomandimi 12 **Transaprenca mbi alokimin e licensave**

Deloitte Audit Albania rekomandon që MEI të publikojë në faqen e saj të internetit metodat për alokimin e licensave, kriteret e përdorura për vlerësimin dhe emrat aplikantëve jo-fitues. Ky publikim do të rrisë transparencën e proçesit dhe do të kontribuojë në përmirësimin e negociatave dhe në efektivitetin e procesit. Përveç kësaj, Shqipëria ka nënshkruar disa marrëveshje investuese me shumë vende (lista e plotë e traktateve në fuqi është dhënë në http://investmentpolicyhub.unctad.org/IIA/CountryBits/2çiiaInnerMen).Këto marrëveshje imponojnë kërkesa strikte për transparencën e procesit të licensimit dhe procedurat e prokurimit. Në këto rrethana, mungesa e transparencës dhe proceset joefektive të licensimit mund ta ekspozojnë vendin kundrejt pretendimeve në arbitrazh ndërkombëtar.

Rekomandimi 13 **Kuadri rregullator për raportimin EITI**

Në mënyrë që të forcojë kuadrin rregullator për raportimin e pagesave dhe për të kapërcyer pengesat e listuara më sipër, Deloitte Audit Albania rekomandon që MSG të hartojë një rregullore plotësuese që adreson të gjitha aspektet si:

_ Analiza paraprake për përcaktimin e materialitetit dhe pagesat e përfshira në raportimin;
_ Koha dhe forma e raportimit nga të liçensuarit
_ Koha dhe forma e raportimit nga ana e institucioneve publike që mbledhin pagesat
_ Koha dhe forma e raportimit të informacionit kontekstual
_ Niveli i procedurave për auditimin e çdo raportimi
_ Format për zgjidhur aspektet e konfidencialitetit etj.

Rregullorja duhet të përcaktojë afatet për një porçes efektiv dhe të lejojë kohë të mjaftueshme që çdo shoqëri dhe institucion publik raportues të planifikojë dhe t'i përgjigjet kërkesave për raportimin EITI në afat. Formularët e raportimit dhe instruksionet përkatëse duhet të përditësohen

për ndryshime në qëllimin e punës dhe kërkesat për raportim, ndryshime në rregullore, si dhe fakte të reja që ndikojnë industrinë nxjerrëse (p.sh. taksa dhe përfitime të reja të zbatuara, investime të reja në industri etj.)

Përzgjedhja e subjekteve raportuese duhet të planifikohet dhe të komunikohet disa muaj përpara fillimit të punës për rakordimin e pagesave. Deloitte Audit Albania sugjeron, të kërkohet nga të gjithë të licensuarit (kur kjo është e mundur) të dorëzojnë raportimin në rrugë elektronike nëpërmjet faqes së internetit ose emailit. Puna rakorduese mund të kryhet për një përzgjedhje kryer sipas qëllimit të raportimit EITI dhe duke reflektuar ndryshimet në sektor. Formularët e miratuar nga MSG mund të publikohen në faqen e internetit të ALBEITI-t, nga ku të licensuarit të kenë mundësi t'i shkarkojnë, t'i plotësojnë dhe t'i ngarkojnë përsëri nëpërmjet një portal-i të dedikuar, nëse sistemtet e EITI Shqipëri e mundësojnë këtë proces. Formularët përfundimtarë e të firmosur mund të dërgohen në vijim me email ose të ngarkohen në të njëjtin portal. Raportimet e marra nga të licensuarit dhe jo të përzgjedhura për rakordim mund të paraqiten si deklarime të njëanshme në raport dhe të gjithë raportimet bashku të krahasohen me të statistika për prodhimin dhe arkëtimet totale të raportuar nga institucionet qeveritare etj.

Përcaktimi i afateve për dorëzimin e deklaratave dhe procesin e rakordimit

Afati për dorëzimin e raportimit duhet të planifikohet në kohë dhe të përfshihet në skedulin e raportimeve të të licensuarve. Si rrjedhojë, koha e nevojshme për mbledhjen e raportimit nga bizneset pritet të ulet dhe gjithashtu priten përmirësime në saktësinë e raportimit. Shoqëritë raportuese dhe institucionet qeveritare duhet të raportojnë në të njëjtin afat. Fillimi i muajit maj të vitit pasues kalendarik mund të përcaktohet si afati i fundit për dorëzimin e formularëve të plotësuar dhe puna rakorduese të kryhet gjatë muajit maj dhe qershor.

Ndonjë pikë e fortë ose dobësitë e identifikuara në proçesin EITI

Pikat e forta

Sekretariati Shqiptar përfshin për herë të parë sipas standartit EITI sektorin e Hidroenergjisë në Raportet EITI 2013 dhe 2014, duke e pozicionuar Shqipërinë deri më tani si të vetmin vend nga 50 vëndet zbatuese që shton vullnetarisht këtë sektor në Raportet EITI. Gjithashtu Shqipëria është i vetmi vend EITI që për të dytin vit radhazi publikon dy raporte EITI brenda një viti dhe kjo na motivon për ta vazhduar këtë Nismë edhe me më shumë përkushtim për vitet e ardhshme.

Dobësitë

Edhe pse viti 2015 pati aktivitete të shumta në promovimin e nismës EITI përsëri bazuar edhe mbi anketimin e dytë që Sekretariati Shqiptar EITI zhvilloi në zonat nxjerrëse rezulton që njohuritë tek popullsia lokale nuk janë në nivelin e pritur. Mungesa e raporteve koherente deri më tani nuk ka nxitur interesin e gazetarëve. Kjo u dëshmua edhe në pjesëmarrjen e ulët në trajnimin që Sekretariati Shqiptar EITI zhvilloi me gazetarët e mediave dhe shtypit në Shqipëri.

Për shkak të vonesave në raportim, kemi bërë amendim të kontratës dhe është vonuar publikimi i raportit.

Kostoja totale e implementimit

Sekretariati Shqiptar EITI për vitin 2015 u mbulua nga fondet e Buxhetit të Shtetit, nga fondet e Bankës Botërore si dhe nga donatorë të tjerë. Financimi nga Buxheti i Shtetit për vitin 2015 për Sekretariatin ishte në nivelin e 17.160.000 lekë. Grandi i Bankës Botërore për vitin 2015 ishte në nivelin e 9.214.388 lekë dhe 38.364 usd dhe financoi kryesisht realizimin e Raportit EITI 2013 dhe EITI 2014 etj. Stafi faktik i Sekretariatit Shqiptar EITI për periudhën 2015 ka qënë me 9 (nëntë) punonjës. Fondi nga

donatorë të tjerë u përdor për pagesën e konsulentëve dhe për aktivitetet EITI të përmendura në këtë raportim.

Më poshtë një informacion i detajuar për vitin 2015.

Fondi Buxhetor

Parashikimi 17,160,000 lekë

Realizuar 15,284,732 lekë (ose 89%)

Fondi i Detajuar Sipas Zërave

A. *Buxheti Shtetit*

Parashikimi 11,350,000 lekë

Realizuar 7,827,000 lekë

C. *Banka Botërore* 9,214,833 lekë

38364 $

B. Sigurimet

Realizuar 3,033,731 lekë

D. Shpenzime të tjera Operative

Buxheti Shtetit 2,228,481 lekë

E. Investime

Realizuar 2195520 lekë

F. Donatorë të tjerë

Realizuar 15081 $

Ndonjë koment shtesë

Falenderojmë Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë për mbështetjen dhe bashkëpunimin e vazhdueshëm ndaj Sekretariatit Shqiptar EITI.

Është diskutuar veprimtaria e raportit përtej MSG-së

Raporti i Aktivitetit Vjetorë 2015 ju prezantua gjithë antarëve të MSG, kontribuesve dhe të e angazhuarve në procesin EITI. Duhet theksuar se janë marrë në konsiderate sygjerimet e ndryshme nga secila palë e interesuar.

Detaje mbi antarësinë e MSG gjatë periudhës

Numri i antarëve të MSG për vitin 2015 ka qënë me pesë (5) përpaqësues nga Shoqëria Civile, pesë (5) përfaqësues nga kompanitë nxjerrëse dhe shtatë (7) përfaqësues nga qeveria. Theksojmë që në çdo takim të MSG njoftohen të gjithë kontribuesit që kanë qënë pjesë e nismës EITI që në themelimin e saj ku çdo sygjerim nga ana e tyre dëgjohet dhe merret në konsideratë. Me ftesë të kryetarit të MSG z. Ilir Betja, në mbledhjet e Bordit EITI morrën pjesë edhe përfaqësues nga institucione të tjera.

E aprovuar nga MSG:

Datë: _____

Foto të aktiviteteve

Prezantime me grupet e interesit mbi mirëqeverisjen e burimeve natyrore



Takim me studentët e Fakultetit të Gjeologjisë dhe Minierave

Mbledhje të MSG

EITI Shqiptar pjesë e lëvizjes “Ta Pastrojmë Shqipërinë”

PWYP dhe Shoqëria Civile Shqiptare

Samiti Shqiptar mbi Naftën, Gazin dhe Energjinë 2015

EITI Shqiptar në shtypin e shkruar

Reklama EITI në Median lokale dhe kombëtare